

## **FORMAT E NDRYSHME TË SHKURORËZIMIT**

### **1. Shkurorëzimi me marrëveshje**

Është një formë e shkurorëzimit të cilën e hasim më së tepërmi në praktikën zvicrane. Nëse të dy bashkëshortët janë të pajtimit apo shprehin dëshirën që të ndahen, atëherë ata kanë mundësi që këte t'a realizojnë përmes procedurës së shkurorëzimit me marrëveshje.

#### **Cilat janë etapat procedurale?**

Përpilohet së pari dokumenti me shkrim i ashtuquajtur « marrëveshje apo konventë shkurorëzimi » e cila, me dokumentet tjera dëshmuese të kërkuara për këto raste, duhet pastaj t'i drejtohet gjykatës kompetente.

Në dokumentin e tillë, nëse është fjala për bashkëshortë që kanë fëmijë të përbashkët, duhet të definohen çështjet lidhur me kujdesin dhe mirëmbajtjen prindërore, të drejtën e vizitës së fëmijëve, pagesa e shtesave fëmijërore, ndarja e pasurive të përbashkëta të fitura gjatë martesës, çështja e pagesës së parave që janë të depozuara në arkën e pensionimit, etj.

Nëse bashkëshortet nuk kanë fëmijë të përbashkët, atëherë marrëveshja e shkurorëzimit duket krejtësisht ndryshme, dhe kalon përmes një forme shumë më të thjeshtësuar. Nuk është aspak e detyrueshme me i shprehur arsyet e shkurorëzimit.

#### **Kush mund t'a përpiloi kërkesën për shkurorëzim me marrëveshje**

Ligji nuk imponon aspak kushte të ashpra për sa i përket personit që mund t'a bëjë kërkesën për rastet e kësaj forme të shkurorëzimit. Kështu që, kërkesa mund të bëhet drejtpërdrejt nga ndonjë palë e interesuar (pra personat që dëshirojnë të shkurorëzohen) apo nga zyrat që merren me çështje juridike.

### **2. Shkurorëzimi me kërkesë të njëanshme (apo edhe të dyanshme)**

Forma tjetër e shkurorëzimit e cila parashikohet sipas ligjit, është kërkesa e njëanshme e shkurorëzimit. Si zakonisht, kjo ndodhë vetëm në rastet kur të dy bashkëshortët nuk arrijnë që të vendosin që ndarja të bëhet me marrëveshje. Mund të jetë e njëanshme, por edhe e dyanshme, në rastet kur që të dy bashkëshortët depozojnë njëkohësisht kërkesë për shkurorëzim, pa ndonjë marrëveshje paraprake.

Më konkretisht, njëri nga bashkëshortët (apo që të dy) nuk është dakord që të bëhet shkurorëzimi. Në të shumtën e rasteve, gjykata merr vendimin e shkurorëzimit, vetëm pasiqë paraprakisht të dy bashkëshortët kanë jetuar të ndarë që dy vite e më tepër. Jeta e ndarë mbrenda afatit të caktuar është shpesh një rezultat i masave të mbrojtjes të bashkësisë martesore të shqiptuara nga gjykata, para se të merret një vendimi definitiv për shkurorëzim.

Në raste të jashtëzakonshme, martesa mund të marrë fund, mbrenda afateve më të shkurtëra, nëse gjykata vlerëson se jeta e përbashkët e të dy bashkëshorteve është e pabërballueshme. Në përgjithësi, shembujtë më të shpesht që lidhen me vendimet e tilla të shkurorëzimit ndodhin kur ushtrohet dhuna në familje.

#### **Kush është gjykata kompetente për shqyrtimin e rastit?**

Është gjykata e rajonit ku gjindet vendbanimi i njërit nga bashkëshortët.

## **Shkurorëzimi dhe pasojat për lejen e qëndrimit të personave që vijnë nga shtetet jashtë bashkësisë evropiane**

Personi i huaj i cili e ka fituar statusin e qëndrimit përmes martesës, natyrisht se rrezikon t'a humbë lejen e tij të qëndrimit, në qoftë se shkurorëzimi ndodhë, për shembull, shumë shpejt pas lidhjes së martesës. Humbja e lejës ndodhë më së shpeshti kur dyshohet se lidhja e martesës ka patur për të vetmin qëllim fitimin e statusit të qëndrimit në Zvicër. Në rastet e shkurorëzimit, sipas ligjit zvicran, statusi i gruasë së huaj mbrohet me një theksë të veçantë.

Neuchâtel, më 9 korrik 2017/LB

### **Informatë e përpiluar nga**

Zyra për këshilla juridike « BEGZATI »  
Av. J. J. Rousseau 7, 2000 Neuchâtel  
E-mail : Lirim.Begzati@hotmail.com  
[www.zyra-begzati.ch](http://www.zyra-begzati.ch)